



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 4082 prot.

Fushë-Arrëz, më 29.12.2025

PROCESVERBAL  
(Zbardhur, më 29.12.2025)

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 26.12.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Afrim Ndoj; Bardhok Qafa; Besjana Marku; Franc Doda; Lezina Ceca; Mustaf Pashkaj; Nikolin Sadiku; Pavlin Qafa; Valentina Lleshaj; Valentin Doçi; Vjollca Tabakaj; Tereze Dema; Zef Cara**  
(14 këshilltarë nga 15 gjithsej);
- **Hil Curri**, Kryetar i Bashkisë;
- **Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar i bashkisë;
- **Ylber Sokoli**, Administrator i Njësise Administrative Fierzë;
- **Lekë Curri**, Kryetar i Fshatit Fushë-Arrëz, Njësia Qendër.

Gjithashtu ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **Specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas agjendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **Z. Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak për muajin Dhjetor 2025! Së pari ju uroj Gëzuar Krishtlindjen!

Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Pjesëmarrja plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes. (14 këshilltarë nga 15 gjithsej)

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak, datë 26.12.2025.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.11.2025.
3. Projektvendim për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Nëntor 2025.
4. Projektvendim për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe funksionet specifike për vitin 2026.

5. Projektvendim për miratimin Paketës Fiskale 2026.
6. Projektvendim për miratimin e Prioriteteve në Shërbime dhe Investime për vitin 2026 e në vazhdim.
7. Projektvendim për miratimin e Planit të Aktiviteteve, Konsultimeve dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026.
8. Projektvendim për miratimin e Buxhetit të vitit 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Fushë-Arrëz.
9. Projektvendim për miratimin e bursave të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026.
10. Projektvendim për miratimin e Planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhë-Qebik në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.
11. Projektvendim “Për Dhënie në Përdorim Fondi Pyjor Publik Loti 1 – Në Ekonominë Pyjore Kryezi, Qafë Plakë-Qafë Shari, Sakat-Lak Hithi për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.4375 Ha; Loti 2 - Në Ekonominë Pyjore Breg Drini, Mertur-Guri, Lumi Berishes për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha; Loti 3-Në Ekonominë Pyjore Breg-Drini, Iballe-Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafë Plakë-Qafë-Shari për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.7500 Ha” në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.
12. Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli ”Qytetar Ndcir” i Bashkisë Fushë- Arrëz, Z. Kol Ded Toplana (Pas vdekjes).
13. Raporti i performancës së Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2024.
14. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve,etj.
15. Të ndryshme.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 1 e rendit të ditës:** Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 26.12.2025.

Atëherë ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

➤ Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës:

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 2 e rendit të ditës:** Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.11.2025.

**Naze Selimaj**, Sekretare e Këshillit Bashkiak: Procesverbali mban gjithëka lidhur me mbledhjen e muajit Nëntor 2025. Këshilltarët e kanë në dosjet e tyre secili, gjithashtu procesverbali është hedhur në web-in zyrtar të Bashkisë (Këshilli Bashkiak) menjëherë mbasi është zbardhur. Nëse keni diçka për të thënë, mundeni. Në të kundërt mendoj të mos humbasim kohë që të lexojmë procesverbalin por të kalojmë në votim për miratimin e tij.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë Procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.11.2025.

➤ Miratohet Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Bashkiak të datës 27.11.2025 me:

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 3 e rendit të ditës:** Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Nëntor 2025. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

**Klotilda Curri**, Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale, shpjegon se për muajin Nëntor 2025 përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës prej 6%, përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës i 6%, 26 familje, me fond 104,758 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 1,745,977 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në shumën 104,376 lekë sipas Njësisë:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 13 familje me fond 41,828 lekë.
2. Njësia Administrative Qafë-Mali, 3 familje me fond 11,821 lekë .
3. Njësia Administrative Blerim, 3 familje me fond 14,313 lekë.
4. Njësia Administrative Fierzë, 3 familje me fond 19,424 lekë .
5. Njësia Administrative Iballë, 4 familje me fond 16,990 lekë .

**Znj. Curri** thekson se në Bashkinë Fushë-Arrëz, trajtohen me Ndihmë Ekonomike, mbi fondin e kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike në masen 6%, familje të cilat janë të varfra ku bazohemi edhe te VKB Nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025”. Qëllimi i trajtimit të këtyre familjeve me bllok-ndihmë 6% , është të ofrohet ndihmë për grupet në nevojë, të cilët nuk sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, si dhe zbutje të varfërisë.

**Klotilda Curri**, Përgjegjëse në Sektorin e Çështjeve Sociale, shpjegon se trajtohen me ndihmën ekonomike 6% të gjitha familjet që dalin nga sistemi për pikë të pamjaftueshme, Drande Bardhok Gjonaj, Liza Ndue Cenaj, Ndoc Kol Prendi, Shkurte Cub Marinaj. Largohet nga bllok-ndihma prej 6% familja: Zef Mejdani ( Njësia Administrative Qafë-Mali). Shtohet në bllok-ndihmën e 6% familja Shkurte Cub Marinaj (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz).

**Franc Doda**, anëtar i Komisionit të Mirëqenies Sociale, thotë se në mbledhjen e komisionit kemi qenë dakord për ndryshimin dhe për shtimin e Shkurte Cub Marinaj (Bashkia Qendër Fushë-Arrëz) në skemën e 6% të ndihmës ekonomike

**Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:**

Meqenëse Komisioni ka rënë dakord, ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Nëntor 2025 përmes votimit:

- Miratohet Projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6 % për muajin Nëntor 2025 me:

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:**

**Pika numër 4 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2026.

**Fationa Selimaj, Drejtoreshë e Zyrës së Burimeve Njerëzore,** thotë se nuk ka ndryshime nga viti i kaluar sa i përket Strukturës dhe nivelit të pagave. I vetmi ndryshim që është bërë është ndryshimi i emërtesës së Specialistëve nëpër Njësi Administrative, nga emërtesa Specialist në emërtesën Inspektor. Ndryshime të tjera nuk ka, pritet të rritet paga minimale por për momentin mbetet në të njëjtën vlerë.

**Franc Doda, anëtar i Komisionit të Ekonomisë,** thotë se kemi diskutuar projektvendimin në mbledhjen e komisionit të Ekonomisë, për pozicionet e sipërpërmendura nuk kemi element që plotësojnë kushtet nisur nga niveli i arsimit për të qenë Specialist, prandaj është dhe ky emërtimi Inspektor.

**Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:**

Ftoj këshilltarët të miratojmë projektvendimin për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2026.

- Miratohet Projektvendimi për strukturën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Administratës së Bashkisë, Njësive Administrative, Institucionet e varësisë dhe Funksionet specifike për vitin 2026 me,

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak:**

**Pika numër 5 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin Paketës Fiskale 2026.

**Vilson Prenga, Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave;**

Përshëndetje të gjithëve! Lidhur me paketën Fiskale 2026, plani i të ardhurave nuk ka ndryshim nga viti 2025. Disa prej ndryshimeve esenciale për vitin 2026 të përfshira në këtë dokument që vlerësohen, janë si më poshtë: Mbi azhurnimet ligjore dhe nënligjore për taksën mbi pasurinë e paluajtshme, referuar shkresës Nr:13/4 Prot. Tiranë, më 06.05.2025 nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore me lëndë: “Mbi problematikat e konstatuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Fushë-Arrëz, në të cilën kërkohet prej pothuajse dy vitesh të bëhen ndryshime në Paketën Fiskale e miratuar kjo me VKB, mbi taksën e ndërtesës të cilat konstistojnë si më poshtë:

1. Është bërë pëmirësimi i bazës ligjore nga specifikimi i të gjitha ndryshimeve që i janë bërë ligjit bazë është vendosur saktësimi i bazës themelore ligjore duke i shtuar vetëm shprehjen “i ndryshuar” që nënkupton ndryshimin e fundit. (faqe 6-7 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026)

2. Paragrafët të cilët ishin vendosur në mënyrë të përmbledhur dhe të përpunuar në Paketën Fiskale 2025, janë saktësuar egzakhtësisht siç janë të përcaktuar në ligj në paketën fiskale 2026. (faqe 9-19 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

3. Paragrafëve të cilëve nuk i'u ishte saktësuar referenca ligjore (neni, pika, aneksi), u janë shtuar përcaktimet përkatëse (faqe 9-19 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

4. Tek tabela Nr.2 në Paketën Fiskale 2026 faqe 12 është theksuar reduktimi në 35% të Taksës mbi ndërtesën për qëllime banimi sipas Aneksit 1, pika b, pasi në Paketën Fiskale 2025 janë bërë llogaritjet në vlerën e reduktuar 35 % por pa e theksuar se sa është % e reduktimit. (faqe 12 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

5. Në tabelat e Paketës Fiskale 2026 në lidhjen me Taksën mbi ndërtesën termi “çmimi mesatar lekë/m<sup>2</sup>” është përshtatur sipas udhëzimeve të VKM-së 132/2018 në “çmimi mesatar referues lekë/m<sup>2</sup>”. (faqe 9-14 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

6. Të gjitha shkalet për llogaritura për taksën mbi ndërtesën janë shprehur në mënyrë analike për të bërë të mundur sqarimin e të gjitha tabelave duke u bazuar në referenca specifike ligjore ku është saktësuar më mënyrë të plotë me shprehje mënyra e llogaritjes së taksës përkatëse. ”. (faqe 15-16 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

7. Është bërë ndryshim në agjendin tatimor ku në Paketën Fiskale 2025 ka qenë vendosur agjend tatimor “Ndërmarrja e Ujesjellës Kanalizime”, e cila është hequr nga paketa fiskale 2026 në bazë të përcaktimeve ligjore të ligjit 9632/2006 i ndryshur, i cili përcakton se Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislationin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave. ”. (faqe 16-19 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026). E njëjta gjë ka ndodhur dhe me vendin se ku do paguhet këto taksa ku në paketën fiskale 2025 nuk saktësohej vendi, ndërsa në paketën fiskale 2026 është vendosur se mund të kryhen pranë Postes Shqiptare dhe pranë çdo banke të nivelit të dytë. (faqe 16-19 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

9. Paragrafët në lidhje me përjashtimet nga taksa mbi pasuritë e palujtshme të cilët ishin vendosur në mënyrë të përmbledhur dhe të përpunuar në Paketën Fiskale 2025, janë saktësuar egzakhtësisht siç janë të përcaktuar në ligj në paketën fiskale 2026. (faqe 16-19 e pasqyruar në Paketën Fiskale 2026).

Vlen të theksohet që për vitin 2026 nuk do të ketë rritje Taksash për banorët e Bashkisë Fushë-Arrëz dhe do ruajnë nivelin e vitit 2025. Përjashtuar ndryshimet e lart përmendura pjesa tjetër do të zbatohet sipas VKB-së Nr.61 datë 23.12.2024 për “Miratimin e Paketës Fiskale 2025”.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

A parashikohet që për vitin 2026 të ndryshojë çmimi i referencës?

**Vilson Prenga**, Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave;

Po, parashikohet por akoma nuk është finalizuar.

**Franc Doda**, anëtar i Komisionit të Ekonomisë:

E kemi shqyrtuar projektin edhe në mbledhjen e komisionit dhe aty kemi diskutuar edhe për vjeljen e taksave. Çdo bashki mbledh taksat vendore. Kemi vënë re se taksat u mbledhen vetëm disa institucioneve apo bizneseve.

Lind pyetja, kush i mbledh taksat e makinave apo tregtarëve ambulant që pothuajse çdo ditë i kemi të pranishëm në qytet? Dihet se taksat nuk vjen kush me i pagu vetë, duhet t'i shkojë fatura në shtëpi. Kemi parë që mbledh taksa policia bashkiake, ku derdhen të ardhurat e mbledhjes së këtyre taksave? Kush është i autorizuar? Për këtë ka fatura që duhet të derdhen në llogarinë bankare të bashkisë. Kjo pjesë mbetet shqetësim për ne, ju si Zyrë e Tatim Taksave duhet ta kontrollojë këtë.

**Vilson Prenga**, Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave:

Duke filluar nga janari do të angazhojmë gjithë strukturën për mbledhjen e taksave si për familjet ashtu edhe për ambulantët konform ligjit.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Franci ka plotësisht të drejtë dhe po konsiston në atë që bashkia duhet të gjejë forma dhe teknika bazuar në ligj siç është dërgimi i faturave në shtëpi apo në biznes, kështu njerëzit do të ndërgjegjësohen dhe në njëfarë forme iu bëhet kulturë që për shërbimet që iu ofrohen ato duhet të paguajnë. Njerëzit duhet ta ndiejnë që kanë përgjegjëshmëri më të lartë ndaj ambientit. Ne si bashki e kemi çmimin e referencës më të ulët. Spitali i paguan, duhet të paguajnë të gjithë.

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës:

Fatura e taksës duhet t'i shkojë çdo qytetari për shërbimet. Në momentin që çdo qytetar merr faturën në dorë, i lind detyra ligjore për ta paguar. Askush nuk ka dëshirë të paguajë ama nëse nuk e bëjnë vetë, bashkia duhet të ndërmarë masa shtrënguese për arkëtimin e këtyre taksave.

Ndërsa sa i përket taksave të tregtimit ambulant, ka vend për përmirësim. Mënyra e pagesës është përmes mandat arkëtimeve dhe mandatpagesat duhet të kryhen përmes postës shqiptare pasi ka ofruar shërbimin me vlerë shumë të ulët të komisionit. Praktikisht për mbledhjen e detyrimeve të tregtarëve ambulant duhet të jenë Zyra e Tatimeve në pararojë e mbështetur nga Policia Bashkiake në bashkëpunim me Zyrën e Financës për pjesën e kontabilizimit të këtyre të ardhurave. Këto bëhen përmes mandat arkëtimeve, mandatpagesave të protokolluara dhe me vulë sekretarie. Besoj që 2026 do jetë viti i përmirësimit të kësaj problematike.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ftoj këshilltarët të miratojnë projektvendimin për Paketën Fiskale 2026.

- Miratohet projektvendimi për Paketën Fiskale 2026 me,

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 6 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e Prioriteteve në Shërbime dhe Investime për vitin 2026 e në vazhdim.

**Tonin Prenga**, Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve:

Sa i përket prioriteteve për investime në vitin 2026 dhe në perspektivë: Prioritetet janë pasqyruar me një listë të cilën këshilltarët e kanë secili në dosjen e tij, janë prioritete në vazhdim të atyre të vitit të kaluar. Këto prioritete në thelb janë përmirësim i objekteve që janë në funksion. Qëllimi është që këto objekte ekzistuese të bëhen bashkëkohore ndaj ne kemi prioritet rijetësimin e objekteve përmes Fondit SHqiptar të Zhvillimit. Jemi në fazën e tretë, me ndihmën e Drejtuesit të bashkisë shpresojmë të financohen edhe disa pallate të tjera për rikonstruksion. Radha është tek pallatet e rrugës Rinia.

Komisioni i Ekonomisë kishte një sugjerim për përfshirjen e sheshit ndërmjet pallateve dhe kopshtit të fëmijëve për asfaltim dhe sheshim, shpresojmë në vazhdim.

Më hollësisht:

#### I-Projekte të Zhvillimit të Territorit

- 1-Rigjenerim i pallateve në Qytetin Fushë-Arrëz, në kuadër të rritjes së efijences së energjisë, projekt në vazhdim
- 2-Ndërtim i një qendre multifunksionale në truallin e ish fabrikes së fibres në Fushe-Arrëz (Qender kulturore, biblioteke, godine për shtresat në nevoje, qender sociale për moshën e trete, vendqendrim për mjetet e linjave të ndryshme, vendparkim), në fazën e përfundimit të projekt/preventivit të zbatimit.
- 3-Përfundim i mureve mbajtës të qytetit Fushë-Arrëz dhe shkallëve lidhëse të tyre (faza e fundit) me vlerë 48 109 808 lekë.
- 4-Mbrojtje lumore dhe perforcim i truallit të objektit Godina e tregut në qytetin Fushe-Arrëz, me vlerë të projektit të zbatimit prej 57 517 380 leke.
- 5-Shëndërrimi i Tregut të Qytetit në Godinë për Bashkinë Fushë-Arrëz. (vlera e projektit të zbatimit është 55,704,408 leke), në fazë të ripërpunimit të preventivit të punimeve për shkak të ndryshimit të çmimeve.
- 6-Mbyllje (Rehabilitim i mbetjeve urbane) ,vend depozitimi Kthesa e Krrabit me vlerë të projektit të zbatimit 35,022,100 leke.
- 7-Blerje kazane për administrimin e mbetjeve jetesore,në sasinë prej 70 cope dhe kapacitet 1.1m<sup>3</sup>, në funksion të shtrirjes së shërbimit edhe në zonën periferike të qytetit Fushe-Arrëz dhe fshatrave përreth si dhe në Njesitë Administrative.
- 8-Gjellbërim dhe rrethim i varrezave publike të qytetit Fushë-Arrëz, (vlera e projektit 18,806,550 leke).
- 9-Gjellbërim dhe rrethim i varrezave publike të fshatit Flet Njesia Administrative Blerim.
- 10-Zgjerim sipërfaqeje, gjellbërim dhe rrethim i varrezave publike në fshatin Kryezi (lagjia Kodra e Geges).
- 11-Gjellbërim dhe rrethim i varrezave publike në fshatrat Gralisht, Bugjon dhe Kokdode Njesia Administrative Fierze.
- 12-Ndërtim i rrjetit të ndriçimit publik në fshatin Kryezi.
- 13-Rikonstruksion i plote i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të përdorura dhe ndërtim i impiantit të trajtimit të tyre në qytetin Fushe-Arrëz dhe fshatrat Fushe-Arrëz dhe Kryezi.
- 14-Rikonstruksion i shkolles Fillore Fushe-Arrëz si qender komunitare në pritje financimi.

#### II-Rrugë+Ura Auto+Ura të Varura

- 1-Ndërhijrje emergjente në rrugën auto-rurale Bardhet -Iballe me vlerë të projektit të zbatimit prej 36,485,908 lek me tvsh.
- 2-Sistemim asfaltim i rrugës auto urbane lagjia Nushaj, qyteti Fushë-Arrëz në fazën e hartimit të projek/preventivit të zbatimit, pas ndryshimeve me kërkesë të banorëve përfitues.
- 3-Sistemim+asfaltim i rrugës auto-rurale për fshatrat Micoj dhe Lumardh+zgjatim segmenti për lagjet Gegaj –Prrez, në fazë hartimi të projektit të zbatimit.

- 4-Rikonstruksion i plotë i rrugës auto-rurale fshati Mzi (vlera e projektit 107,520,625 lekë), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.
- 5- Rikonstruksion i rrugës auto-rurale lagjia Bardhet ,Njësia Administrative Qafë-Mali (vlera e projektit 10,669,703 lekë) , ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.
- 6-Sistemim +asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në fshatrat Kryezi, Orosh (degëzimet nga aksi kryesor Bardhet-Iballë në drejtim te lagjeve).
- 7-Sistemim +asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në fshatit Qafë-Mali (degëzimet nga aksi kryesor Bardhet - Qafë-Mali për lagjet Palucaj, Marenaj, Vasiaj, Likaj, Jakaj.
- 8-Sistemim+asfaltim i rrugëve të brendshme auto-rurale në Njësinë Administrative Fierze (degëzimet nga aksi kryesor Fushë-Arrëz-Fierzë), si dhe rrugë të brendshme auto-rurale të fshatit Fierzë.
- 9-Rikonstruksion rruges auto-rurale Bugjon-Gralisht Njesia Administrative Fierze +ure auto ne perroin Bugjon.
- 10-Hapje traseje te re (segmenti rrugor auto-rural Fierze -Aprisë Guri), Njësia Administrative Fierzë, (vlera e projektit 111,177,692 lekë), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.
- 11-Hapje degëzim te ri rruge auto rurale lagjia Kolgjokaj fshati Dardhe Njesia Administrative Blerim.
- 12-Rikonstruksion rruga auto rurale lagjia Nderlymna, Njesia Administrative Iballe.
- 13-Hapje rruge te re qe lidh Njesite Administrative Iballe dhe Fierze,
- 14-Riparim i plote i ures pasarele ne fshatin Levoshe, Njesia Administrative Iballe.
- 15- Riparim i plote i ures auto perroji Sylajve fshati Flet.

### III-Ujësjiellësat

- 1-Ndërtim i ujësjiellësit të ri në fshatin Kryezi me vlere te projektit 145,994,014 leke), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve.
- 2-Rikonstruksione të pjesshme në rrjetet e shpërndarjes në ujësjiellësat e fshatrave Truen, Qebik, Flet, Blerim, Kulumri dhe Xath, Njësia Administrative Blerim.
- 3-Ndërtim ujesjiellësi ri në fshatrat Mzi, Gralisht dhe Fierzë dhe rikonstruksion i pjesshem i ujesjiellesit në fshatin Porav, Njësia Administrative Fierzë.
- 4-Ndërtim ujesjiellesi te ri ne fshatin Shopel, Njesia Administrative Iballe.
- 5-Perfundim i Ujesjiellesit Gere – Qender fshati Iballe(faza e dyte, depo+rrjeti shperndares+mates uji), Njesia Administrative Iballe.

### IV-Veptra Vadihtëse

- 1-Permiroesim i infrastruktures se vadihtjen ne fshatin Fushë-Arrez (kanali ujitës Micoj-Dedaj-Marinaj+ kanali ujitës Micoj -Nushaj ), ne faze te riperpunimit te preventivit te punimeve per shkak te ndryshimit te çmimeve dhe shtese projekti per lagjen Nushaj.
- 2-Rikonstruksion i pjesshem në kanalin vadihtës në fshatin Mzi (linja kryesore e furnizimit deri tek rrjeti i shperndarjes), Njësia Administrative Fierzë
- 3-Rikonstruksione të pjesshme në kanalet vadihtëse në fshatrat Bugjon dhe Arst, Njësia Administrative Fierzë.
- 4-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vadihtës në fshatin Kryezi (Mardodaj –Miriaj Palushaj), Njesia Administrative Qafë-Mali.
- 5- Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vadihtës në fshatin Qafë-Mali(lagjia Likaj-Marenaj),Njesia Administrative Qafë-Mali.
- 7-Rikonstruksione të pjesshme në kanalet vadihtëse në fshatrat, Truen dhe Qebik, Njësia Administrative Blerim.
- 8-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vadihtës Gere, në fshatin Iballe, Njesia Administrative Iballe.
- 9-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vadihtës “Vada e Zhupit”, në fshatin Berishe, Njesia Administrative Iballe.

- 10-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës Arifaj në fshatin Kryezi, Njesia Qafë-Mali.
- 11-Rikonstruksion i pjesshem i kanalit vaditës në fshatin Gralisht, Njesia Administrative Fierze.
- 12-Rikonstruksion i kanalit vadites Dervish-Brahaj, fshati Kryezi, Njesia Administrative Qafë-Mali.
- 13-Rikonstruksion i kanalit vadites perroji Orosh- Qender, fshati Kryezi, Njesia Administrative Qafe-Mali.

#### V-Shëndetësia

- 1-Rikonstruksion i Qendres Shendetesore Fushe-Arrez.
- 2-Rikonstruksion i plotë Qendrës Shëndetësore ne Njesinë Administrative Fierze (me vlere projekti 4,000,000 leke).
- 3-Rikonstruksione të pjesshme të Qendrave Shëndetësore në fshatrat Porav, Apripë –Guri, të Njesisë Administrative Fierzë.
- 4-Ndërtim Ambulance tip A-2 në fshatin Bugjon, të Njesisë Administrative Fierzë.
- 5-Rikonstruksione te plota te qendrave shendetesore ne fshatrat, Xath, Flet, Dardhe, Njesia Administartive Blerim.

#### VI-Arsimi

- 1-Rikonstruksion i plote i shkolles 9-vjeçare ne fshatin Dardhe, Njesia Administrative Blerim,vlera e projektit te zbatimit eshte 13,759,296 leke.
- 2-Rikonstruksione të pjeshme në shkollat 9-vjeçare Porav , Arst-Miliska , Njesia Administrative Fierzë.
- 3/1Rikonstruksione të pjeshme në shkollat 9-vjeçare Bugjon , Njesia Administrative Fierzë.
- 3/2-Ndertim i nje godine te re per shkollen 9 –vjeçare te fshatit Bugjon Njesia Administrative Fierzë.
- 4-Rikonstruksion i anekseve të shkollave 9-vjeçare në fshatrat Berishë e Epër dhe Mërtur, Njësia Administrative Iballë.
- 5-Rikonstruksione te pjeshme ne shkollat 9-vjeçare te fshatrave , Truen, Flet,Njesia Administrative Blerim.

#### VII-Pyjet dhe Kullotat

- 1-Hartim i planeve te menaxhimit dhe mbareshtimit per te gjitha ekonomite pyjore te Bashkise Fushe-Arrez.
- 2-Pyllezim ne zonat e djegura, te degraduara dhe te eroduara.
- 3-Ndertim te sistemeve te pritave malore per mbrojtje nga erozioni.

**Afrim Ndoj**, Anëtar i këshillit, pyet a ka ndonjë gjë konkrete lidhur me rehabilitimin ujësjellësave të fshatrave?

Asgjë nuk është e parealizueshme, kostot për lagjet nuk janë të mëdha, një pjesë janë për rehabilitim dhe një pjesë janë për sistemin të veprave të shpërndarjes.

Secili paguan nëse do të ishte e mundur të kishim ujin në oborr. Jemi banorë të bashkisë Fushë-Arrëz, jemi taksapagues dhe kemi të drejtën të kërkojmë gjënë më elementare ujin e pijshëm, s'po kërkojmë luks. Vlera në lekë është e pallogaritshme. Unë kërkoj shërbimin, për mua s'ka rëndësi kush do e bëjë, bashkia apo ShA. Këto janë investime të papërfillshme.

**Tonin Prenga**, Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Investimeve:

Dihet tashmë se Ujësjellësi ka kaluar me VKB tek SHA që e ka qendrën në Shkodër. Bashkia mund të investojë por gjithmonë me dakordësinë e Ujësjellës-Kanalizimet

**Afrim Ndoj**, Anëtar i këshillit:

Të krijohet mundësia që lagje-lagje të bëhen investime lidhur me Ujësjellësin, 2 km tub sepse nuk mund të presim investimet e SHA-së me vonesat e tyre.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nuk e pengon ligji Bashkinë për të investuar për faktin që Ujësjiellësi i ka kaluar SHA-së. Një mundësi shumë e mirë është FSHZH, ku të kërkojnë tuba, burimet njerëzore i kemi.

**Hil Curri**, Kryetar i Bashkisë:

Ju përshtes të gjithëve dhe njëkohësisht ju uroj Gëzuar Krishtlindjen gjithë besimtarëve Katolikë dhe Gëzuar Natën e madhe besimtarëve myslimanë që këtë herë rastësisht kanë qëlluar në të njëjtën datë, 25 dhjetor.

Dëgjova me vëmendje projektin e Prioriteteve, është modest për kushtet ku ndodhemi. Lidhur me taksat kemi pasë rritje. Jemi përpjekur të mbledhim taksat gjithë atyre që banojnë dhe investojnë në bashkinë tonë. Sa i përket Ujësjiellësit, SIIA, Shkodër ka rritur çmimin pa dakordësinë tonë në mënyrë krejt të njëanshme dhe kjo rritje çmimi nuk është në proporcion me shërbimin që ofron shoqëria.

Ne si bashki lidhur me lobimet dhe unë personalisht jam përpjekur maksimalisht të bashkëpunojmë me çdo lloj personi brenda apo jashtë shtetit, qeveritar apo jo qeveritar, organizata dhe të tjerë për të sjellë investime në bashkinë tonë.

Thithja e investimeve si në fushën eolike ashtu edhe në atë fotovoltaike është një ç'ardhje për bashkinë tonë si për të gjitha bashkitë e tjera dhe kjo shton të ardhurat.

Çdonjëri në administratë duhet të marrë përgjegjësitë e veta.

E falenderoj Këshillin Bashkiak për gjithë mbështetjen që na ka dhënë me miratimin e projekteve.

**Besjana Marku**, anëtare e këshillit:

Për sa i përket objekteve të arsimit 9-vjeçar, tash 5 vjet asnjë gjë konkrete nuk po shohim, asnjë rikonstrukcion shkollë që është i domosdoshëm, edhe para jush edhe me ju edhe mbas jush më duket se nuk do të bëhet asgjë. Shkolla 9-vjeçare Flet ka gati 3 vjet që është mbyllur sepse nuk ka fëmijë. Për tu rihapur një shkollë ligji parashikon të ketë minimumi 10 nxënës. Mua më intereson të bëhen projekte dhe investime reale aty ku ka nevojë por jo te kjo shkollë që nuk ka asnjë nxënës dhe tash tre vjet nuk funksionon si shkollë. Nësia Administrative Blerim ka 4 shkolla të cilat janë në gjendje të mjerueshme. Ju lutemi mos futni në lista të prioriteteve investime që janë të panevojshme si shkolla që përmenda më sipër por investoni aty ku është domosdoshmëri.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Tonin, Rishikoni listat dhe hiqni objekte të tilla si kjo shkollë jofunksionale për investime.

**Mikel Qafa**, investimi do të kalojë në një shkollë tjetër që ka nevojë.

Mos të ndodhë që të bëjmë investime si në shkollën Qafë-Mali para shumë vitesh e cila u mbyll menjëherë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2026 e në vazhdim duke hequr nga lista Rikonstrukcionin e pjeshëm në shkollën 9-vjeçare Flet, Njësia Administrative Blerim e cila nuk funksionon më si shkollë:

- Miratohet Projektvendimi për Prioritetet në Shërbime dhe Investime për vitin 2026 e në vazhdim me:

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 7 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e Planit të Aktiviteteve, Konsultimeve dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026.

**Naze Selimaj**, Sekretare e Këshillit Bashkiak:

Mbështetur në ligjin 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak", Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku, Kryesia e KB në bashkëpunim me Përgjegjësin e Financës, z. Dritan Lika ka ndërtuar një projekt për planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026, i cili paraqitet sot në formën e projektvendimit përpara këshilltarëve:

Bashkëlidhur projektvendimit për planin e aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026 gjenden:

Plani i aktiviteteve Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz 2026;

Plani vjetor i konsultimeve 2026;

Shpenzime për konsultime (detajuar nga plani vjetor i konsultimeve)

Këshilli Bashkiak Fushë Arrëz Buxheti Vjetor 2026

Sa i përket Planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz 2026, në tabelë janë përshkruar aktivitetet e Këshillit Bashkiak për çdo muaj, ku përveç mbledhjeve plenare dhe mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme në çdo muaj janë përshkruar aktivitete të tjera si Konsultime me komunitetin për çështje të Draft PBA, ndryshim buxheti, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore;

Konsultime me komunitetin për çështje për që sipas ligjit kanë nevojë për konsultim, norma e standarte të shërbimeve publike dhe funksioneve të tjera ligjore; Strategji e Plane; Ceremoni dhënie titull nderi, etj

Këshilli do të mbaje dëgjesa publike me qytetaret gjatë muajve Shkurt, Prill, Maj, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor dhe ky plan dëgjësash mund të ndryshojë në varësi të projektvendimeve të paraqitura nga Bashkia.

Sa i përket Buxhetit Vjetor 2026, ky është i pasqyruar në faqen e fundit me shifra konkrete dhe tashmë ju e keni dhe në dosjet tuaja. Përveç kësaj çdo projekt gjendet i afishuar në web-in zyrtar të bashkisë Fushë-Arrëz.

Faleminderit!

**Afrim Ndoj**, anëtar i KB:

Çfarë nënkupton pika 13. Ekspertizë për çështje të ndryshme të këshillit?

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Këshilli Bashkiak ka të drejtë të marrë ekspert për çështje të caktuara në fusha të ndryshme dhe paguhet, kjo për llogari vetëm të çështjeve që lidhen me Këshillin Bashkiak.

Ne e kemi planifikuar le të jetë në rast nevojë.

Në mënyrë analogjike çdo institucion mund të marrë ekspert ligjor për çështje të caktuara.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Gjej rastin këtu të falenderoj Projektin Bashki të Forta dhe konkretisht Elvin Hoxha si Përfaqësues i BtF për mbështetjen që i ka dhënë vazhdimisht bashkisë tonë.

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës: Në vazhdim të vlerësimit të Projektit Bashki të Forta unë kam një propozim personalisht duke qenë përfutur i këtij projekti që ju si këshill me mekanizmat tuaj ta nderoni Projektin Bashki të Forta minimalisht me akordimin e një Certificate Mirënjohje nga ana e KB.

Atëherë nëse nuk ka diskutime, unë ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendim për miratimin e Planit të Aktiviteteve, Konsultimeve dhe Buxhetit e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026.

- Miratohet Projektvendimi për Planin e Aktiviteteve, Konsultimeve dhe Buxhetin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz për vitin 2026 me,

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 8 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin Buxhetit të vitit 2026 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Fushë-Arrëz.

*Shënim: Mbledhjes i bashkohet anëtari i Këshillit Bashkiak, Valentin Doçi dhe nga ky moment në sallë bëhen 14 këshilltarë.*

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës:

Prezantim i buxhetit për vitin 2026 si dhe buxhetit Afatmesëm 2026-2028:

Kam kënaqësinë të paraqes sot para jush dokumentin më të rëndësishëm që bashkia i paraqet Këshillit Bashkiak atë të Projektvendimit për Buxhetin e Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026 si dhe PBA 2026-2028. Buxheti i kësaj periudhe financiare është ndërtuar mbi realizimin e treguesve buxhetorë në vite duke ndjekur hap pas hapi një agjendë të mirëpërcaktuar të të gjithë aktiviteteve të parashikuara për realizimin e këtij procesi. Si një dokument thelbësor, ai rregullon veprimtarinë ekonomike të Bashkisë jo vetëm në raport me institucionet e tjera por, mbi të gjitha me vetë komunitetin.

Buxheti i Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026 vazhdon të ndërtohet mbi bazën e misionit që ka Bashkia Fushë-Arrëz:

Misioni: Fushë-Arrëzi, është një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve rajonale në veri të Shqipërisë, një zonë e ripërtërirë ekonomikisht, që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

Të dhëna mbi Bashkinë Fushë-Arrëz:

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës-Prishtinë dhe gjendet në pjesën verilindore të Shqipërisë.

Bashkia Fushë-Arrëz përbëhet nga katër Njësi Administrative dhe Bashkia Qendër dhe numëron rreth 11 498 banorë ose 3791 familje.

Fushë-Arrëzi njihet si qendër e vogël industriale ku mbizotëron për vite me radhë industria e pasurimit të bakrit dhe prodhimit të ujit. Kjo ka bërë që të kemi një ulje të ndjeshme të papunësisë.

Disa të dhëna mbi buxhetin:

Politikat e Buxhetit të Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026 kanë synuar:

1. Mbështetjen financiare të kërkesave të komunitetit;
2. Zgjerimin e biznesit në Bashki, pavarësisht potencialit ekonomik të Bashkisë;
3. Investime të shoqëruar me politika specifike në favor të grupeve të ndryshme;
4. Uljen e papunësisë;
5. Rritjen ekonomike etj.

Risi për buxhetin e vitit 2026 janë:

Bashkia Fushë-Arrëz është përzgjedhur nga Ministria e Financës si Bashki pilot për programin e buxhetit me metodologjinë e re. Kjo përfshirje krijon mundësi që buxheti të planifikohet në 6 programe buxhetore. Programi do të bëhet në nivel produkti.

Të ardhurat e Bashkisë për vitin 2026 do të vijnë nga Taksat dhe Tarifatat Vendore të cilat janë programuar në përputhje me Paketën Fiskale të hartuar;

Nga Transferta e pakushtëzuar: Transferta sektoriale; Grant i trashëguar nga viti 2025 (rishikim buxheti janar 2026); Të ardhurat e trashëguara nga viti 2025 ( rishikim buxheti janar 2026).

Në tabelë paraqiten niveli taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026. Për vitin që vjen taksat dhe tarifave vendore ruajnë thuajse të njëjtin nivel prej 28 milion e 555 mijë lekë.

Buxheti i bashkisë është parashikuar në vlerën 361 milion lekë, e ndarë në specifikat: të ardhurat e veta; Transferta e pakushtëzuar: Transferta specifike; Të trashëguara me destinacion; Të trashëguara pa destinacion.

Aktiviteti i Bashkisë është i lidhur ngushtësisht edhe me shpenzimet përveç të ardhurave.

Aktiviteti ekonomik i Bashkisë është i lidhur ngushtësisht me shpenzimet për:

Paga dhe Sigurime shoqërore; Shpenzime operative dhe mirembajtje, pa të cilat Bashkia nuk do të mund të përmbushë asnjë prej detyrimeve të veta; Investime kapitale; Transferta (Këshilli i qarkut, Fondi rezerve, emergjencia dhe kontigjencia etj).

Përves funksioneve bazë, Bashkia ka dhe funksionet specifike si më poshtë:

Arsimi parashkollor dhe ai i mesëm; Rruget rurale; Administrimi i pyjeve; Mbrojtja nga zjarri; Ujitja dhe kullimet.

Shpenzimet Sipas Programeve

AA155 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 120,491,381lekë

AB155 - Siguria publike 40,953,904 lekë; AC155 - Zhvillimi Ekonomik dhe Rural 40,809,337 lekë; AD155 - Arsimi, Kultura, Sporti, Çështjet Sociale 74,520,093 lekë; AE155 - Punët publike 82,560,231 lekë; AF155 - Fondi Rezervë dhe Kontigjencë 2,000,000 lekë.

Këto të dhëna janë të përkthyer edhe në grafik të cilët janë të shfaqur në monitor për lehtësi të kuptuari. Kjo ishte një panoramë e shkurtër lidhur me buxhetin e vitit 2026.

Faleminderit!

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

A ruhet për këtë vit niveli i shërbimeve bazike për qytetarët?

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës: Po pavarësisht gjithçkaje ruhet niveli i shërbimeve bazike për qytetarët.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Atëherë nëse nuk ka diskutime, unë ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për miratimin e Buxhetit Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026:

- Miratohet projektvendimi për Buxhetin Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetin e vitit 2026 me:

**14 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 9 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e bursave të nxënësve të Arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025-2026.

**Altin Engjëlli**, Specialist për arsimin në bashki: Nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë sipas kritereve të përcaktuara në VKM- së 666, datë 10/10/2019, i ndryshuar me (VKM Nr. 511, datë 27.7.2022) “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”. Këtë vit kanë aplikuar 3 ( tre ) nxënës të vitit të parë në shkollat e mesme profesionale që janë me pasaportizim në Bashkinë Fushë-Arrëz, prej të cilëve përfitojnë 3 ( tre ) nxënës. Ne si bashki kemi patur 10 kuota por nuk kemi patur aplikime të tjera.

Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e bursave.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026:

- Miratohet projektvendimi për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026 me:

**14 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 10 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e Planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhë-Qebik në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

**Ardmir Doda**, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b ; VKM-në nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” ; Manualin e Planeve të Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave 2019, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,

me Nr.864 prot, datë 30.01.2019”, Shkresa nr. 37 Prot datë 07.10.2025 “Dërgohet plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe-Qebik”; I propozojmë Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz miratimin Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe-Qebik” për vijimin e procedurave për miratimin e tij nga Ministria e Mjedisit dhe Turizimit sipas Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni nr.11, pika 2, germa b.

Të ardhurat në ekonominë pyjore Dardhe Qebik llogariten të jenë në total 164 191 623 lek.

Shpenzimet në ekonominë pyjore Dardhe Qebik llogariten të jenë në total 261 470 000 lek

Bashkëlidhur këtij Projektvendimi është relacioni shpjegues për hartimin e Planit të Mbarështimit të ekonomisë pyjore “Dardhe-Qebik” me të cilin janë njohur këshilltarët edhe më parë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhe-Qebik në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

- Miratohet projektvendimi për Planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore Dardhe-Qebik në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz me,

**14 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 11 e rendit të ditës:** Projektvendim “Për Dhënie në Përdorim Fondi Pyjor Publik Loti 1 – Në Ekonominë Pyjore Kryezi, Qafë Plakë – Qafë Shari, Sakat – Lak Hithi për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.4375 Ha; Loti 2 – Në Ekonominë Pyjore Breg Drini, Mertur – Guri, Lumi Berishes për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha; Loti 3 – Në Ekonominë Pyjore Breg – Drini, Iballe-Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafë Plakë – Qafë Shari për Energji të Rinovushme (Eolike) Në Një Sipërfaqe Prej; 1.7500 Ha” në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz”

**Ardmir Doda**, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54 shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4 ; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” të ndryshuar; VKM-ne nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” të ndryshuar ; VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore” ; Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11; Urdherit të Kryetarit nr.522 date 01.10.2024 “Për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 1 - Në ekonominë pyjore Kryezi, Qafë Plakë – Qafë Sharri, Sakt - Lak hithi, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.4375 Ha; Loti 2 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Mertur – Guri, Lumi i Berishes, Iballe – Mezi 1&2, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha, Loti 3 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Iballe – Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafë Plakë – Qafë Sharri për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.7500 Ha” ; Shkresën nr.222 date 12.12.2025 “Dërgim i Raporteve Tekniko-Ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 1 - Në ekonominë pyjore Kryezi, Qafë

Plake – Qafë Sharri, Sakt - Lak hithi, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.4375 Ha; Loti 2 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Mertur – Guri, Lumi i Berishes, Iballe – Mezi 1&2, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha, Loti 3 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Iballe – Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafë Plake – Qafë Sharri për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.7500 Ha” nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, i propozojmë Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz fillimin e procedurave për dhënie përdorim/qira me anë të konkurimit publik (ankand) të sipërfaqes së fondit pyjor publik sipas Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11”, që i përket Loti 1, Loti 2, Loti 3.

Qëllimi i përdorimit është dhënia në përdorim/qira të përkohshëm të sipërfaqes fond pyjor Energji të rinovushme (Eolike), (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)”.

Gjithçka është e pasqyruar në Relacionin shprehues, harta pyjore me gjurmen dhe raportet tekniko-ekonomik për lotet 1, 2 dhe 3 me ngastrat dhe n/ngastrave që propozohen të jepen në përdorim.

Faleminderit!

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Sa janë të ardhurat që përfiton bashkia përmes këtij projekti?

**Ardmir Doda**, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Të ardhurat e bashkisë përmes këtij projekti janë rreth 10 milion lekë të vjetra , ky është çmimi fillestar, por mund të ofrohet edhe më shumë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

A jeni siguruar që të mos ketë konflikte nga ana e banorëve për pronat dhe pyjet dhe çfarë është thënë në dëgjuesat publike?

**Ardmir Doda**, Drejtor i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave:

Po, pyetjet tuaja shumë me vend, kemi kryer gjithë hapat dhe procedurat ligjore, janë bërë edhe dëgjuesat publike.

**Hil Curri**, Kryetar i Bashkisë:

Në të gjitha dëgjuesat që janë bërë në 4 Njësitë administrative paralel me buxhetin nuk kemi hasur në problematika të tilla pretendimesh sa i përket ngastrave në projekt.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për Dhënie në Përdorim Fondi Pyjor Publik Loti 1 – Në Ekonominë Pyjore Kryezi, Qafë Plakë – Qafë Shari, Sakat – Lak Hithi për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.4375 Ha; Loti 2 – Në Ekonominë Pyjore Breg Drini, Mertur – Guri, Lumi Berishes për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha; Loti 3 – Në Ekonominë Pyjore Breg – Drini, Iballe-Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafë Plake – Qafë Shari për Energji të Rinovushme (Eolike) Në Një Sipërfaqe Prej; 1.7500 Ha” në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz.

- Miratohet projektvendimi për Dhënie në Përdorim Fondi Pyjor Publik Loti 1 – Në Ekonominë Pyjore Kryezi, Qafë Plakë – Qafë Shari, Sakat – Lak Hithi për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej; 1.4375 Ha; Loti 2 – Në Ekonominë Pyjore Breg Drini, Mertur – Guri, Lumi Berishes për Energji të Rinovushme (Eolike) në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha; Loti 3 – Në Ekonominë Pyjore Breg – Drini, Iballe-Mezi

**14 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 12 e rendit të ditës:** Projektvendim për miratimin e propozimit për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë- Arrëz, Z. Kol Ded Toplana (Pas vdekjes).

**Fationa Selimaj**, Drejtoreshë e Zyrës së Burimeve Njerëzore:

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; në ligjin 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligji Nr.94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në RSH"; pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi Z. Kol Toplana dhe pas Vendimit Nr 444, datë 16.10.2025 të AIDISSH mbi pastërtinë e figurës së Kol Ded Toplana me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij, Sektori i Burimeve njerëzore, në bashkinë Fushë-Arrëz, duke konsideruar propozimin e bërë u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë që të vlerësohet figura dhe personaliteti i Z. Kol Ded Toplana, duke iu dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohje publike për të gjithë kontributin dhe punën në funksion të komunitetit: T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Kol Ded Toplana me motivacionin: “Për kontribut të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare, zhvillimin ekonomik të zonës, ruajtjen e traditës dhe kulturës shqiptare, pajtimin e gjaqeve, shërbimin ndaj komunitetit dhe rolin e tij si figurë shembullore e ndershmërisë, urtësisë dhe vlerave më të larta qytetare”.

Ky titull t'i jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij si mbështetës i luftës nacionaliste dhe për rolin e tij të rëndësishëm në odat e pajtimit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në komunitet, për virtytet e larta të fjalës, besës, ndershmërisë dhe mikpritjes, duke u bërë shembull i vlerave tradicionale dhe i harmonisë shoqërore.

Z. Kol Ded Toplana njihet nga banorët e trevës si njeriu model i vlerave të traditës, kulturës, dhe atdhetarizmit.

Për të gjitha meritat propozohet t'i akordohet titulli "Qytetar Nderi i Bashkisë Fushë-Arrëz".

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë me votë projektvendimin për miratimin e propozimit për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë- Arrëz, Z. Kol Ded Toplana (Pas vdekjes).

- Miratohet projektvendimi për dhënie titulli ”Qytetar Nderi” i Bashkisë Fushë- Arrëz, Z. Kol Ded Toplana (Pas vdekjes) me,

**14 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 13 e rendit të ditës:** Raporti i performancës së Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2024.

**Mikel Qafa**, Zëvendëskryetar i bashkisë:

Raporti i Performancës është edhe në faqen zyrtare ëeb të bashkisë. Jemi në 10 bashki më të mira, kjo shoqërohet edhe me një masë përfitimi financiar për bashkinë, sapo të ketë gati qeveria.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Gjej rasti të falenderoj edhe njëherë personalisht përfaqësuesin e Btf. Elvin Hoxha për rolin nxitës dhe informues ndaj nesh që ka luajtur në këtë proces.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 14 e rendit të ditës:** Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve,etj.

**Lekë Curri**, Kryetar i fshatit Fushë-Arrëz:

Përshëndetje të gjithëve! Meqenëse bashkia jonë po rreshtohet ndër bashkitë më të mira për shkak të shërbimeve dua të them se ka vend për shërbime përsëri. I kam shpreh kërkesat e fshatit edhe në dëgjuesën publikë, lagjia jonë ka nevojë për ndërhyrje në vijat vaditëse. Buxheti është i pakët krahasuar me shtrirjen gjeografike.

Gjithashtu kam nisë një kërkesë KB, për një problematikë që kanë mes vetit djemtë e një familje në fshatin Fushë-Arrëz. Ne si kryesi fshati jemi përpjekur por nuk kemi arritur të gjejmë një zgjidhje ndaj ju kemi drejtuar ju si Këshill Bashkiak. Mirë do të ishte që këshilli të ngrinte një komision që të shkojë në terren dhe të verifikojë situatën duke lobuar për gjetjen e një zgjidhje.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Lekë, ne e kemi ngrit komisionin për atë problematikë në mbledhjen e Tetorit dhe jemi të gatshëm edhe unë bashkë me komisionin dhe specialistë nga bashkia të investojmë kohë për problematikën në fjalë deri sa të gjejmë një zgjidhje, kuptohet sa të jetë e mundur.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 15 e rendit të ditës:** Të ndryshme

Unë propozoj të ngrejmë një grup pune të përbërë nga 3 këshilltarë (këtij grupi mund t'i bashkohen edhe punonjës nga bashkia) për përgatitjen e dokumentacionit gjatë muajit Janar, lidhur me dhënien e një Titulli Nderi Projektit Bashki të Forta.

Unë propozoj të jenë në këtë grup këshilltarët: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Afrim Ndoj.

Ju ftoj të miratojmë me votë ngritjen e grupit të punës të përbërë prej 3 këshilltarëve, **Franc Doda, Pavlin Qafa, Afrim Ndoj** i cili do të përgatit dokumentacionin për dhënien e një Titulli Nderi Projektit BtF .

- Miratohet ngritja e grupit të punës të përbërë prej 3 këshilltarëve, **Franc Doda, Pavlin Qafa, Afrim Ndoj** i cili do të përgatit dokumentacionin për dhënien e një Titulli Nderi Projektit BtF me,

**13 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Hil Curri**, Kryetar i Bashkisë: Falenderoj Këshillin Bashkiak për gjithë mbështetjen, gjithashtu falenderoj administratën e bashkisë për punën e bërë e njëkohësisht ju uroj të gjithëve një vit të mbarë!

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Një falenderim të veçantë e kam për të gjithë këshilltarët që janë me vendbanim larg dhe kanë qenë të përkushtuar të vijnë një herë për komisionet dhe një herë për mbledhjen dhe kjo është një sfidë.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtë.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj Gëzuar Vitin e Ri 2026 dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

**SEKRETAR**

**Naze SELIMAJ**



**KRYETAR**

**Nikolin BARDHOKU**



Zef Ure Livi!

Jonida Tabakuq

Adem Hoxha

Nikolosh Sardika

Bardhok Rafa

Mustaf Tashkaj

Lerina Leca

Valentina Lleshaj

Yardem Riza

Tereze Demq Hemo

Franc Doda

Valentin Dogi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**LISTË-PREZENCË PËR PJESËMARRJE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT NË**  
**MBLEDHJEN E KËSHILLIT BASHKIAK TË DATËS 26.12.2025**

| Nr. | Emër      | Mbiemër | Nr. telefoni & whatsapp<br>(nëse ka ndryshuar) | Firma   |
|-----|-----------|---------|------------------------------------------------|---------|
| 1.  | Zef       | Lera    |                                                | Lina!   |
| 2.  | Vollu     | Tabakaj |                                                | P.      |
| 3.  | Ajdar     | K. P.   |                                                | PK      |
| 4.  | Nikol     | Scutku  |                                                | Sc      |
| 5.  | Lepina    | Lera    |                                                | Lera    |
| 6.  | Mustaf    | Tashkaj |                                                | Must    |
| 7.  | Valentina | Kleshaj |                                                | Kleshaj |
| 8.  | Tereze    | Demor   |                                                | Demor 2 |
| 9.  | Yovani    | Raf     |                                                | Raf     |
| 10. | Bejana    | Marku   |                                                | Marku   |
| 11. | Tereze    | Demor   |                                                | Demor 2 |
| 12. | Barolhok  | Dejor   |                                                | Dejor   |
| 13. | Franc     | Soda    |                                                | Soda    |
| 14. | Valentin  | Doci    |                                                | Doci    |
| 15. |           |         |                                                |         |